



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3696/ 8 prot

Datë 12.02.2025

V E N D I M
Nr. 230/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaïd Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 12.02.2025 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Filara” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur shërbime mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-12184-07-04-2024, me objekt “Furnizim, vendosje dhe mirëmbajtje e elementeve të brandimit në Qëndrat e Kujdesit ndaj Klientit dhe zyrat Administrative të OSHEE Group sh.a per dy vjet” me fond limit: 39,848,500 (tridhjetë e nëntë milion e tetëqind e dyzet e tetë mijë e pesëqind) leke, pa TVSH ose 396,147.7 (treqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e dyzet e shtatë pikë shtatë) euro pa TVSH. Referuar kursit të këmbimit të B.SH datë 04.07.2024 1 euro = 100.59 All, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 30.10.2024 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike Group sh.a.

Autoriteti Kontraktor:

Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike Group sh.a.
Adresë: Blv “Gj. Fishta”, Nd.Nr. 88, H.1, Njësia Administrative Nr.7, 1023, Tiranë.

Ankimues:

Operatori ekonomik “Filara” SHPK me NIPT K51611059N, me adresa: Rruga “Kavajës”, Ish Kombinati “Misto Mane”, Pranë fabrikës Kaon, Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:**I***Vlerësimi Paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 05.07.2024 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur shërbime mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-12184-07-

04-2024, me objekt *“Furnizim, vendosje dhe mirëmbajtje e elementeve të brandimit në Qëndrat e Kujdesit ndaj Klientit dhe zyrat Administrative të OSHEE Group sh.a per dy vjet”* me fond limit: 39,848,500 (tridhjetë e nëntë milion e tetëqind e dyzet e tetë mijë e pesëqind) leke, pa TVSH ose 396,147.7 (treqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e dyzet e shtatë pikë shtatë) euro pa TVSH. Referuar kursit të këmbimit të B.SH datë 04.07.2024 1 euro = 100.59 All, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 30.10.2024 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike Group sh.a.

II.2. Në datën 30.10.2024 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor si dhe sistemit të prokurimeve elektronike rezulton se në datën 25.11.2024 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1- “Filara” SHPK	30,500,000	lekë	skualifikuar
2- “Ddixhi Print Al” SHPK	35,303,000	lekë	kualifikuar

II.4. Në datën 25.11.2024 operatori ekonomik “Filara” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me arsyen se:

Nuk ka objekt veprimtari objektin e tenderit.

Nuk paraqet dokumentacion provues mbi disponimin e makinerive te kerkuara ne piken 2.3.4, persa i perket:

- Makineri printimi me cilesi me bojera UV ekologjike dhe boje te bardhe per printim ne materiale te buta dhe te forta (dru, forex, plexiglass) me ngjyra te ndryshme deri ne 3.5m gjeresi.*

- Makineri printimi me kapacitet te mjaftueshem prodhimi per materiale te buta (banners) me bojera UV ekologjike per ambiente te brendshme. Me kapacitet te mjaftueshem prodhimi dhe printimi i se ciles duhet te jete deri ne 5 m gjeresi.*

- Makineri printimi per sinjalistika ne materiale per printim direkt ne materiale te forta. Mundesi printimi i sinjalistikave ne gjuhen e shenjave (reliev, boje te bardhe dhe transparente) ne menyre qe sinjalistika te jete e lexueshme edhe nga personat me shikim te kufizuar. Me kapacitet te mjaftueshem me siperfaqe minimumi 120 cm x 60 cm.*

Edhe pas kerkeses per sqarim te bere ne sistem rezulton se dokumentacioni qe ka dorezuar nuk provon disponimin e ketyre makinerive.

II.5. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor si dhe sistemit të prokurimeve elektronike rezulton së më datë 10.12.2024 është Publikuar Njoftim Fituesi Paraprak, i procedurës së prokurimit objekt- ankimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga ana e autoritetit kontraktor.

II.6. Në datën 19.12.2024, nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankesa me nr. A/2024/4911 dhe me nr. 3696/2024 prot, datë 19.12.2024, e operatorit ekonomik “Filara” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur shërbime mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-12184-07-04-2024, me objekt “Furnizim, vendosje dhe mirëmbajtje e elementeve të brandimit në Qëndrat e Kujdesit ndaj Klientit dhe zyrat Administrative të OSHEE Group sh.a per dy vjet” me fond limit: 39,848,500 (tridhjetë e nëntë milion e tetëqind e dyzet e tetë mijë e pesëqind) leke, pa TVSH ose 396,147.7 (treqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e dyzet e shtatë pikë shtatë) euro pa TVSH. Referuar kursit të këmbimit të B.SH datë 04.07.2024 1 euro = 100.59 All, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 30.10.2024 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Shperndarjes se Energjië Elektrike Group sh.a. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua, se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimes “Filara” SHPK me pretendimet si më poshtë vijon:

Në datën 05.07.2024 enti prokurues Operatori i Shperndarjes se Energjië Elektrike Group sh.a publikoi procedurën e prokurimit të hapur mbi vlerën e kufirit të lartë monetarë me numër reference: REF-12184-07-04-2024.

Në datën 25.09.2024, autoriteti kontraktor modifikoi dokumentat e tenderit. Në datën 30.10.2024, ne dorëzuam oferte në këtë tender.

Në datën 15.11.2024, në SPE mberriti një kerkese për sqarim nga autoriteti kontraktor, ku kerkonte si më poshtë vijon:

Mbeshtetur në nenin 82 të VKM 285 dhe në dokumentat e tenderit pika në të cilën është kerkuar:

- për të vërtetuar disponimin e këtyre makinerive operatorët ekonomik duhet të paraqesin fatura tatimore ose zhdoganimin. Për makineritë me qira duhet të paraqitet kontrata e qirasë e vlefshme, e shoqëruar me dokumentacion që vërteton pronësinë e qiradhënësit (fatura tatimore ose zhdoganimi). Autoriteti kontraktor i lind e drejta të verifikojë disponimin e makinerive, për këtë qëllim operatorët ekonomike duhet të paraqesin një deklaratë të nënshkruar nga Administratori i shoqërisë.

- Lutemi të na vini në dispozicion dokumentacionin provues mbi vetedeklarimin në shtojcën nr. 8, seksioni B (për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme) (nëse kërkohen) për disponimin e mjeteve /makinerive me kontratë qiraje, ku përveç kontratës së qirase kërkohet edhe dokumentacioni që vërteton pronësinë e qiradhenesit, por edhe skedë, teknik, katalogun apo dokumentacion tjetër teknik që pasqyron të dhënat e makinerive. Dokumentacioni i kerkuar duhet të dorëzohet brenda 3 ditëve.

Në datën 15.11.2024, i derguam nëpërmjet SPE autoritetit kontraktor përgjigjen dhe kerkesen, si më poshtë:

Pershendetje I/E nderuar Pranojme verifikimin e makinerive dhe konfirmojme dorezimin e dokumentave provues sipas deklarimeve ne Formularin e Vetedeklarimit dhe DST-se, por jemi te paqart ne lidhje me afatin nese afati 3 ditor eshte pune apo kalendarik, pasi dita e trete perkon me ditën e diele dhe nuk mund te behet protokollimi i dokumentave hyres nga autoriteti kontraktor. Gjithashtu sellim ne vemendie se ne DST e ngarkuar ne sistemin elektronik app.gov.al nuk ishin te percaktuar skedat teknike te paisieve dhe kerkoime shtyren e afatit duke qene se skedat teknike nuk jane ne giuhen shqipe dhe perkthimi dhe noterizimi i tyre kerkon nje afat me te gjate kohor. Kerkojme bashkepunimin tuaj te menjehershem me qellim permbushjen e afateve kohore.

Në datën 19.11.2024, nëpërmjet SPE autoriteti kontraktor, na sqaron si me poshtë vijon:

Pershendetje,

Ne vijim te kerkeses se dates 14.11.2024, ju bejme me dije se afatet jane kalendarike, pervecse kur parashikohet ndryshe ne ligj, megjithate po ju joftome se autoriteti ka vendosur tju lej afat qe dorezimi i dokumentacionit te behet brenda orarit zyrtare te dites se sotme. Gjuha e tenderit eshte shqip dhe anglisht, ne keto kushte dokumentacioni ne gjuhe angleze mund te dorezohet i pa perkthyer. Nese nga ana juaj nuk do te dorezohet dokumentacioni i kerkuar brenda dites se sotme, KVO do ta cmoje kete fakt edhe ne vleresim. Faleminderit.

Në datën 25.11.2024, nëpërmjet SPE u njohëm me njoftimin e vlerësimit të ofertave, si me poshtë:

Operatoret Ekonomik	vlera te ofertuara	Refuzuar
FILARA	30.500.000.00	Po
DIXHI PRINT-AL	35.303.000.00	Jo

Në datën 25.11.2024, u njohëm me arsyet e skualifikimit, ku në SPE na erdhen tre grupe arsyesh skualifikimi, si më poshtë:

Nuk provone disponimin e makinerive te kerkuara ne piken 2.3.4 përkatesisht:

- Makineri printimi me cilesi me bojera UV ekologjike dhe boje te bardhe per printim ne materiale te buta dhe te forta (dru, forex, plexiglass) me ngjyra te ndryshme deri ne 3.5m gjeresi.
 - Makineri printimi me kapacitet te mjaftueshem prodhimi per materiale te buta (banners) me bojera UV ekologjike per ambiente te brendshme. Me kapacitet te mjaftueshem prodhimi dhe printimi i se ciles duhet te jete deri ne 5 m gjeresi.
 - Makineri printimi per sinjalistika ne materiale per printim direkt ne materiale te forta. Mundesi printimi i sinjalistikave ne giuhen e shenjave (reliev, boje te bardhe dhe transparente) ne menyre qe sinjalistika te jete e lexueshme edhe nga personat me shikim te kufizuar. Me kapacitet te mjaftueshem me sipërfaqe minimumi 120 cm x 60 cm.
- Edhe dokumentacioni i dorezuar ne baze te kerkeses per sqarim nuk deshmon plotesimin e kesaj kerkese.

Në datën 10.12.2024, autoriteti kontraktor, publikoi Njoftimin e Fituesit Paraparak duke shpallur fitues DIXHI PRINT-AL, si dhe nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronik, na njoftoi se e kanë filluar afatet e ankimimit.

Në mbështetje të përcaktimit të nenit 110/2 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 për prokurimin publikë, i ndryshuar po paraqesim ankesën tonë për këtë tender.

PRETENDIMI I

Kundërshtojme arsyen e skualifikimit si në vijim: nuk e ka objekt veprimtarie objektin e tenderit.

ARGUMENT I

- Ne Seksionin 2 të DST-ve enti juaj prokurues ka përcaktuar objektin e prokurimit si me poshtë: Seksioni 2: Objekti i kontratës: furnizim, vendosje dhe mirëmbajtje e elementeve të brandimit në qendrat e Kujdesit ndaj Klientit dhe zyrat Administrative të OSHEE Group sh.a per dy vjet.

- Ne Seksionin 2.1 të DST-ve ka përcaktuar kodin sipas Fjalorit të Perbashket të Prokurimit, si me poshtë: 2.2 Kodi sipas Fjalorit të përbashkët të Prokurimit (FPP) - Materiale të stampuara dhe produkte të përafërta.

Shenim: Në këtë seksion enti juaj prokurues nuk ka përcaktuar kodin sipas VKM-se Nr. 457, datë 30.7.2021 Për Miratimin e Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit, i ndryshuar.

- Referuar VKM-së Nr. 457, datë 30.7.2021 Për Miratimin e Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit, i ndryshuar, përshkrimi i Kodi sipas Fjalorit të përbashkët të Prokurimit (FPP), si në vijim: materiale të stampuara dhe produkte të përafërta nuk ekziston.

- Referuar Njoftimit të Fituesit Paraparak të publikuar nga enti juaj prokurues na rezulton se fitues është shpallur kompania Dixhi Print Al me nipt: K72210003J.

- Nga verifikimi i bërë në faqen zyrtare të QKB-se (ëëë.qkb.gov.al) verifikuara objektin e veprimtarisë së kësaj kompanie, ku në Ekstraktin e Regjistrimit Tregtar, kjo kompani ka objekt veprimtarie si me poshtë: Tregti me shumice dhe pakice të mjeteve tipografike. Printime digitale të gjitha llojet për libra, revista dhe reklama. Import eksport i makinerive tipografike të gjitha llojet printimeve dixhitale për reklama, libra dhe revista. Shtypshkrime për të gjitha llojet. Import dhe eksport i strukturave të ndriçuara të sinjalistikës rrugore dhe të gjitha llojet e reklamave.

Në përgjithësi shoqëri mund të kryejë çdo veprimtari të nevojshme e të dobishme të lejuar nga ligji për relizimin e objektit të aktivitetit të saj. Organizim evente, prodhim materiale filmike, produksion dhe postproduksion për spote, dokumentare dhe prezantime të ndryshme, prodhim konstruksione. Dhenien e tendave të ndryshme me qira. Zhvillim dhe menaxhim aplikacionesh ëëbi, zhvillim dhe menaxhim programesh kompjuterik, zhvillim dhe menaxhim platformash dixhitale. Produkte promocionale. Shitje, blerje mobilje të ndryshme. Punime druri, melamine

dhe te ndryshme. Brandim automjetesh. Realizimi i dekoreve dhe elementeve dekorative per evente te ndryshme.

Ku objektet e veprimtarise së kësaj kompanie si në vijim: tregti me shumice dhe pakice te mjeteve tipografike. Import eksport i makinerive tipografike te gjitha llojet printimeve dixhitale per reklama, libra dhe revista. Import dhe eksport i strukturave te ndriáuara te sinjalistikes rrugore dhe te gjitha llojet e reklamave.

Në pergjithesi shoqeri mund te kryeje cdo veprimtari te nevojshme e te dobishme te lejuar nga ligji per relizimin e objektit te aktivitetit te saj. Dhenien e tendave te ndryshme me qira. Zhvillim dhe menaxhim aplikacionesh ëëbi, zhvillim dhe menaxhim programesh kompjuterik, zhvillim dhe menaxhim platformash dixhitale. Shitje, blerje mobilje te ndryshme. Punime druri, melamine dhe te ndryshme. Brandim automjetesh. Nuk janë të ngjashme me objektin e prokurimit, ndërsa objeketet e veprimtarisë së kesaj kompanie si ne vijim: printime digitale te gjitha llojet per libra, revista dhe reklama. Shtypshkrime per te gjitha llojet. Organizim evente, prodhim materiale filmike, produksion dhe postproduksion per spote, dokumentare dhe prezantime te ndryshme, prodhim konstruksione. Produkte promocionale. Realizimi i dekoreve dhe elementeve dekorative per evente te ndryshme.í, janë të ngjashme me objektin e prokurimit te ketij tenderi.

Shoqeria jone Filara ka objektin e veprimtarise se saj sipas Ekstraktin e Rregjistrir Tregtar, veprimtarite, si me poshte: Shtepi Botuese, botime te ndryshme, artistike, letrare,shkollore, universitare dhe botimeve te monografive shkencore ne fushen e albanologjise. Shtypshkronje, shtypshkrime me element sigurie, fletepalosje, agjenda, flyer, katalog, kartevizita, banera, postera, roll up, kalendar muri, kalendar tavoline, canta, revista, letra me koke, blloqe recetash, stilolapsa me logo, broshura, zarfa, etiketa, etj. Agjenci trajnimesh per zhvillimin e vazhduar profesional,t rajnimin dhe certifikimin e punonjesve arsimor,trajnime te ndryshme. Tregtim kancelarish te ndryshem,mjete didaktike mesimore. Organizim eventesh, dekore, festa dhe materiale promocionale te ndryshme ,etj.

Kompania jonë jo vetem ka në objektin e veprimtarise, veprimtari identike me veprimtarine e kompanise Dixhi Print Al si ne vijim: shtypshkronje, shtypshkrime me element sigurie, fletepalosje, agjenda, flyer, katalog, kartevizita, banera, postera, roll up, kalendar muri, kalendar tavoline, canta, revista, letra me koke, blloqe recetash, stilolapsa me logo, broshura, zarfa, etiketa, etj. Organizim eventesh, dekore, festa dhe materiale promocionale te ndryshme ,etj.ë, por këto veprimtari janë të ngjashme me objektin e prokurimit te ketij tenderi.

Në përfundim, arsyeja e skualifikimit e sipërpermendur nuk qendron, pasi objekti i veprimtarisë së kompanise tonë është identike me objektin e veprimtarisë së kompanise fituese Dixhi Print Al, si dhe kompania Filara ka në objektin e veprimtarisë Objektin e Prokurimit. Për më tepër, me këtë vleresim KVO-ja ka shkelur Parimin e Barazise dhe Parimin e Trajtimit te Barabarte të përcaktuar në nenin 3 te ligjit nr. 162/2020 Per prokurimin publik, i ndryshuar.

PRETENDIMI II

Kundershtojme arsyen e skualifikimit si ne vijim: nuk ploteson piken 2.3.4 te kapaciteteve teknike persa i perket disponimit te makinerive te printimit si me poshte:

- Makineri printimi me cilesi me bojera UV ekologjike dhe boje te bardhe per printim ne materiale te buta dhe te forta (dru, forex, plexiglass) me ngjyra te ndryshme deri ne 3.5m gjeresi.*
- Makineri printimi me kapacitet te mjaftueshem prodhimi per materiale te buta (banners) me bojera UV ekologjike per ambiente te brendshme. Me kapacitet te mjaftueshem prodhimi dhe printimi i se ciles duhet te jete deri ne 5 m gjeresi.*
- Makineri printimi per sinjalistika ne materiale per printim direkt ne materiale te forta. Mundesi printimi i sinjalistikave ne gjuhen e shenjave (reliev, boje te bardhe dhe transparente) ne menyre qe sinjalistika te jete e lexueshme edhe nga personat me shikim te kufizuar. Me kapacitet te mjaftueshem me sipërfaqe minimumi 120 cm x 60 cm. Edhe me dokumentacionin shtese te dorezuar pas kërkeses per sqarim ky operator nuk arrin te provojë disponimin e këtyre makinerive te kerkuaraë.*

ARGUMENT II

- Në pikën 2.3.4 të shtojcës 8 të DST-ve enti juaj prokurues ka vendosur kriterin kualifikues, si më poshtë: 2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet/makinerite e mëposhtme:

- Makineri per printime ne sticker te cilesise se larte me bojera ekologjike dhe boje te bardhe per materiale transparente e pajisur me makineri per prerje sipas formes.*
- Makineri printimi e cilesise se larte me bojera UV ekologjike dhe boje te bardhe per printim ne materiale te buta dhe te forta (dru, xham, forex) me ngjyra te ndryshme minimumi 3.5m gjeresi.*
- Makineri printimi me kapacitet te mjaftueshem prodhimi per materiale te buta (banners) me bojera UV ekologjike per ambiente te brendshme. Me kapacitet te mjaftueshem prodhimi dhe printimi i se ciles duhet te jete minimumi 5 m gjeresi.*
- Makineri printimi per sinjalistika ne materiale per printim direkt ne materiale te forta. Mundesi printimi i sinjalistikave ne gjuhen e shenjave (reliev, boje te bardhe dhe transparente) ne menyre qe sinjalistika te jete e lexueshme edhe nga personat me shikim te kufizuar. Me kapacitet te majftueshem me sipërfaqe minimumi 120 cm x 60 cm.*
- Makineri printimi per materialin textil me bojera uji ekologjike per ambiente te brendshme per personalizimin e perdeve dhe kalander per perpunim tekstili me gjeresi minimale 320 cm.*
- Makineri prerese per materialet: Adeziv, Tekstil, pvc, dru, plexiglass, metal.*
- Makineri lazer per funksionet: prerje metal, perpunim shkrime 3D, gdhendje druri.*

Për të vërtetuar disponimin e këtyre makinerive operatorët ekonomik duhet të paraqesin fatura tatimore ose zhdoganimin. Për makineritë me qira duhet të paraqitet kontrata e qirasë e vlefshme, e shoqëruar me dokumentacion që vërteton pronësinë e qiradhënësit (fatura tatimore ose zhdoganimi). Autoriteti kontraktor i lind e drejta të verifikojë disponimin e makinerive, per kete qellim operatorët ekonomike duhet të paraqesin nje deklarate te nenshkruar nga Administratori i shoqerise. Per te permbushur kriterin e mesiperm ne fazen e ofertimit,

operatori ekonomik duhet te deklaroje disponimin e makinerive ne formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.

Sqarim: përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST, sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 për miratimin e rregullave të Prokurimit Publikë i ndryshuar. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar, i pari duhet te dorëzoje dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat a, b, d, dh, e, h, i, j të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin).

Në datën 25.09.2024, enti juaj prokurues e ka modifikuar këtë kriter kualifikues, si më poshte:
Në shtojcën 8, pika 2.3.4 e Kapaciteteve Teknike, ne dokumenta tenderit modifikohet :
Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet/makinerite e mëposhtme:

- Makineri printimi me cilesi me bojera UV ekologjike dhe boje te bardhe per printim ne materiale te buta dhe te forta (dru, forex, plexiglass) me ngjyra te ndryshme deri ne 3.5m gjeresi.
- Makineri printimi me kapacitet te mjaftueshem prodhimi per materiale te buta (banners) me bojera UV ekologjike per ambiente te brendshme. Me kapacitet te mjaftueshem prodhimi dhe printimi i se ciles duhet te jete deri ne 5 m gjeresi.
- Makineri printimi per sinjalistika ne materiale per printim direkt ne materiale te forta. Mundesi printimi i sinjalistikave ne gjuhen e shenjave (reliev, boje te bardhe dhe transparente) ne menyre qe sinjalistika te jete e lexueshme edhe nga personat me shikim te kufizuar. Me kapacitet te mjaftueshem me sipërfaqe minimumi 120 cm x 60 cm.
- Makineri printimi per materialin textil me bojera uji ekologjike per ambiente te brendshme per personalizimin e perdeve dhe kalander per perpunim tekstili me gjeresi minimale 320 cm.
- Makineri prerese per materialet: Adeziv, Tekstil, pvc, dru, plexiglass, metal.
- Makineri lazer per funksionet: prerje metal, perpunim shkrime 3D
- Te gjitha produktet e kerkuara jane per perdorim te ambienteve te brendeshme dhe nuk pranohet te jene me bashkime.
- Nje makineri mund te kryej nje ose me shume funksione mjafton te vertetohet me te dhenat teknike (skede teknike apo cdo dokument tjeter te vlefshem qe verteton realizimin e proceseve te punes apo sherbimeve).
- Printer mjaftojne edhe nga nje per secilin version. Mjafton te mbulojne permasen me te madhe te kerkuar pa bashkime.

Ky modifikim behet ne zbatim te vendimit te KPP-se nr. 1227/2024 date 10.09.2024.

Shënim: Ky kriter kualifikues eshte modifikuar duke HEQUR dokumentaconin me te cilin vërtetohet përmbushja e këtij kriteri dhe konkretisht është hequr pjesa si më poshte:

Per te permbushur kriterin e mesiperm ne fazen e ofertimit, operatori ekonomik duhet te deklaroje disponimin e makinerive ne formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës

përkatëse të DST. Sqarim: përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST, sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik i ndryshuar. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar, i pari duhet të dorëzojë dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat a, b, d, dh, e, h, i, j të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin).

Megjithatë për këtë kriter kualifikues nga ana e entit tuaj kontraktor nuk është kërkuar mënyra se si do të vërtetohet përmbushja e këtij kriteri, përsëri kompania Ffilara Sh.p.k ka dorëzuar në SPE shtojcën Nr. 9 Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit ku në pjesën III b: Deklaratë për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen) ka deklaruar pajisjet që disponon dhe që janë kërkuar në këtë kriter kualifikues. (Bashkelidhur shtojca 9 Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit).

Në datën 15.11.2024, në SPE mbërriti një kërkesë për sqarim nga autoriteti kontraktor, ku kërkonte si me poshte vijon:

Mbeshtetur në nenin 82 të VKM 285 dhe në dokumentat e tenderit pika në të cilën është kërkuar:

- Për të vërtetuar disponimin e këtyre makinerive operatorët ekonomik duhet të paraqesin fatura tatimore ose zhdoganimin. Për makineritë me qira duhet të paraqitet kontrata e qirasë e vlefshme, e shoqëruar me dokumentacion që vërteton pronësinë e qiradhenësit (fatura tatimore ose zhdoganimi). Autoriteti kontraktor i lind e drejta të verifikojë disponimin e makinerive, për këtë qëllim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një deklaratë të nënshkruar nga Administratori i shoqërisë.
- Lutemi të na vini në dispozicion dokumentacionin provues mbi vetëdeklarimin në shtojcën nr. 8, seksioni B (për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme) (nëse kërkohen) për disponimin e mjeteve /makinerive me kontratë qiraje, ku përveç kontratës së qirase kërkohet edhe dokumentacioni që vërteton pronësinë e qiradhenësit, por edhe skedë, teknik, katalogun apo dokumentacion tjetër teknik që pasqyron të dhënat e makinerive. Dokumentacioni i kërkuar duhet të dorëzohet brenda 3 ditëve.

Kjo kërkesë e KVO-se ishte në kundërshtim me parashikimet e nenit 82 të VKM 285 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar, pasi në këtë fazë të vlerësimit KVO-ja nuk mund të aplikonte përcaktimet e këtij neni, pasi sikurse përmendëm dhe më lart ky kriter kualifikues nuk linte vend për sqarime.

Kjo kërkesë e KVO-së për të dorëzuar kontratën e qirase apo të deklaratës së zhdoganimit apo të faturës tatimore të blerjes për të vërtetuar disponimin e makinerive të përcaktuara në pikën 2.3.4 të shtojcës 8 të DST-së është në kundërshtim me vetë këtë kriter kualifikues, pasi sikurse

përmendem dhe me lart ky kriter kur eshte modifikuar nuk është përcaktuar nga enti juaj prokurues se me çfarë dokumentacioni do të vërtetohet.

Kjo kërkesë e KVO-se për të dorezuar skedat teknike të makinerive të përcaktuara në piken 2.3.4 të shtojcës 8 të DST-ve është në tejkalim të vetë përcaktimeve të kriterit kualifikues të përcaktuar në piken 2.3.4 të shtojcës 8 të DST-ve, pasi sikurse përmendem dhe me lart në këtë kriter kualifikues t modifikuar nga ana e entit tuaj kontraktor nuk është kërkuar që të dorëzohen skedat teknike të makinerive të kërkuara.

Ndonëse kërkesa e KVO-së e datës 15.11.2024 është bërë në shkelje të procedurave të parashikuara nga rregullat e prokurimit publik (të sipërpermendura), përsëri kompania jon ifilaraë nuk hezitoi që ti dërgonte dokumentacionin vërtetues, duke dorezuar në datën 19.11.2024 skedat teknike për të vërtetuar disponimin e makinerive të kërkuara në kriterin kualifikues të pikës 2.3.4 të shtojcës 8 të DST-ve dhe konkretisht:

Për Makinerin e printimit me cilesi me bojera UV ekologjike dhe boje te bardhe per printim ne materiale te buta dhe te forta (dru, forex, plexiglass) me ngjyra te ndryshme deri ne 3.5 m gjeresi kemi dorezuar skedën teknike të makinerise G 1632, ku sipas skedës teknike kjo makineri është në përmasat 2820 x 640 x 1420 mm.

- Makineri printimi me kapacitet të mjaftueshem prodhimi për materiale te buta (banners) me bojera UV ekologjike për ambiente të brendshme. Me kapacitet te mjaftueshem prodhimi dhe printimi i se ciles duhet te jete deri ne 5 m gjeresi kemi dorezuar skeden teknike të makinerisë G 1832, ku sipas skedës teknike kjo makineri është në përmasat 4590 x 1100 x 920 mm.

- Makineri printimi për sinjalistika në materiale për printim direkt ne materiale te forta. Mundesi printimi i sinjalistikave në gjuhen e shenjave (reliev, boje te bardhe dhe transparente) në menyre që sinjalistika të jetë e lexueshme edhe nga personat me shikim të kufizuar, me kapacitet të mjaftueshem me sipërfaqe minimumi 120 cm x 60 cm. Për këte makineri kemi dorezuar skedën teknike te makinerise G96, ku sipas skedës teknike kjo makineri është në përmasat 2300 x 1250 x 935 mm. Edhe dokumentacioni i dorëzuar në bazë të kërkesës për sqarim nuk dëshmon plotesimin e kësaj kërkesë sipas AK.

Të gjendur në këto rrethana kërkojmë skulifikimin e shoqërisë Dixhi Print Al Sh.p.k duke qënë se, nuk e ka të ngjashme objektin e veprimtarisë së saj me objektin e proadurës në fjalë si dhe kërkojmë kualifikimin e ofertës sonë duke qënë se i përmbushim më përpikmëri të gjitha kriteret e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor duke përfshirë edhe pretendimet e Autoritetit Kontraktor për skualifikimin e ofertës sonë në lidhje me objektin e veprimtarisë së shoqërisë Filara Sh.p.k dhe disponimin e disa makinerive për realizimin e shërbimit objek prokorimi.

Bashkangjitur ankesës do të gjeni:

- Formularin e vetëdeklarimit të shoqërisë Filara Sh.p.k*
- Kontratën e Qirase ndëemjet paleve Nr. 56 Prot. Datë 29.10.2024*
- Skedat Teknike të makinerive të sipërcituar (Të Perkthyer)*

II.7. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 3696/2 prot., datë 20.12.2024 janë publikuar arsyet që operatori ekonomik ankimes “Filara” SHPK pretendon se përmbushen prej tij dhe i kundërshton me anë të ankesës me nr. 3696/2024 prot, datë 19.12.2024.

II.8. Me shkresën nr. 3973/13 prot, protokolluar me tonën me nr. 3696/3 prot datë 07.01.2025 me objekt: “Kthim Përgjigje” autoriteti kontraktor ka dërguar pranë Komisionit Prokurimit Publik, aktin e trajtimit të ankesës të operatorit ekonomik ankimes, nga verifikimii të cilit rezulton se ka vendosur mospranimin e ankesës si më poshtë vijon:

Bazuar ne Urdherin Nr. 3973/11 prot, datë 21.12.2024 për pezulimin e proçedures dhe shqyrtimin e ankesës se ardhur nga ana e Operatorit Ekonomik “Filara” shpk, me NIPT K51611059N e regjistruar me nr. aplikimi ankese online A/2024/4911, date 19.12.2024, me poshte referuar si OE, per dokumentat e tenderit te procedurës së prokurimit me nr: REF-12184-07-04-2024 dhe me objekt “Furnizim, vendosje dhe mirembajtje e elementeve te brandimit ne Qendrat e Kujdesit ndaj Klientit dhe zyrat Administrative te OSHEE Group sh.a, per dy vjet” dhe ne baze te ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar, në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Rregullat e Prokurimit Publik” i ndryshuar, bëme shqyrtimin e ankeses dhe argumentave te paraqitur dhe konkludojme sa më poshte:

Operatori i Shperndarjes së Energjisë Elektrike Group sh.a. (me poshte referuar si OSHEE Group sh.a), ka publikuar ne SPE formularin e njoftimit paraprak te fituesit për procedurën me objekt “Furnizim, vendosje dhe mirembajtje e elementeve te brandimit ne Qendrat e Kujdesit ndaj Klientit dhe zyrat Administrative te OSHEE Group sh.a, per dy vjet”. Në date 19.12.2024, është regjistruar ne Sistemin Online te Ankesave, ankese me OE “Filara” shpk, me NIPT K51611059N, e regjistruar me nr. aplikimi ankese online A/2024/4911. Në Komisionin e Prokurimit Publik ankese mban nr. protokolli 3696/2024, date 19.12.2024, me status “paguar” mandatin e pagesës dorezuar.

Bazuar ne nenin 110 dhe nenin 111 te ligjit nr. 162/2020 “Per prokurimin publik” indryshuar dhe ne nenin 97 te VKM nr. 285 date 19.05.2021 i ndryshuar, vendosëm të marrim në shqyrtim ankesën me nr. 3696/2024, date 19.12.2024 te operatorit ekonomik “Filara” shpk, me NIPT K51611059N për vleresimin e proçedures. Ne perfundim te afatit per paraqitjen e argumentave rezulton qe ne sistem e ankesave online nuk ka argumenta te dorezuar.

Ankese e ardhur nga “Filara” sh.p.k është brenda afateve ligjore te parashikuara nga ligji nr. 162/2020, “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe si e tillë u mor në shqyrtim nga KSHA dhe i cili ne perfundim ka konkluduar se:

1. Persa i perket pikes së parë të ankimit të paraqitur nga Ju, cit;

Nuk e ka objektin e veprimtarie objektin e tenderit.

...Shoqeria jone Filara ka ne objektin e veprimtarise se saj sipas Ekstraktin e Rregjistrin Tregtar, veprimtarite, si me poshte: Shtepi Botuese, botime te ndryshme, artistike, letrare, shkollore, universitare dhe botimeve te monografive shkencore ne fushen e albanologjise. Shtypshkronje, shtypshkrime me element sigurie, fletpalosje, agjenda, flyer, katalog, kartvizita, banera, postera, roll up, kalendar muri, kalendar tavoline, canta, revista, letra me koke, blloge recetash, stilolapsa me logo, broshura, zarfa, etiketa, etj. Agjenci trajnimesh per zhvillimin e vazhduar profesional, trajnimin dhe certifikimin e punonjesve arsimor ,trajtime te ndryshme. Tregtim kancelarish te ndryshem,mjete didaktike mesimore.

Organizim eventesh, dekore, festa dhe materiale promocionale te ndryshme, etj....

KSHA ne shqyrtim te Ankeses sqaron se:

Ne kriteret e pergjithshme per kualifikim pika 1/ a kerkohet:

a) është i regjistruar ne regjistrin tregtar sipas legjislacionit te vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaem ne rastin e nje organizate jofitimpruese, ka ne fushën e veprimtarise objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

Referuar objektit te veprimtarise te pershkruar ne ekstraktin tuaj nuk rezulton qe shogeria juaj te kete objekt veprimtarie qe perfshine dhe brandime.

Persa shpjeguem me lart pretendimi Juaj nuk qendron.

2. Persa i perket pikes se ankimit te paraqitur nga Ju, cit;

PRETENDIMI II

Kundershtojme arsyen e skualifikimit si ne vijim: nuk ploteson piken 2.3.4 te kapaciteteve teknike persa i perket disponimit te makinerive te printimit si me poshte:

- Makineri printimi me cilesi me bojera UV ekologjike dhe boje te bardhe per printim ne material te buta dhe te forta (dru, forex, plexiglass) me ngjyra te ndryshme deri ne 3.5m gjeresi.
- Makineri printimi me kapacitet te mjaftueshem prodhimi per materiale te buta (banners) me bojera UV ekologjike per ambiente te brendshme. Me kapacitet te mjaftueshem prodhimi dhe printimi i se ciles duhet te jete deri ne 5 m gjeresi.

- Makineri printimi per sinjalistika ne materiale per printim direkt ne materiale te forta.

Mundes printimi i sinjalistikave ne giuhen e shenjave (reliev, boje te bardhe dhe transparente) ne menyre qe sinjalistika te jete e lexueshme edhe nga personat me shikim te kufizuar. Me kapacitet te mjaftueshem me siperfage minimumi 120 cm x 60 cm.

Edhe me dokumentacionin shtese te dorezuar pas kerkeses per sqarim ky operator nuk arrin te provoje disponimin e ketyre makinerive te kerkuara.

KSHA ne shqyrtim te Ankeses sqaron se:

Nga analiza e dokumentacionit te dorezuar ne SPE por edhe materialit plotesues te dorezuar pas kerkeses per sqarim te bere nga KVO rezulton se makinerite e deklaruar dhe dokumentat te dorezuara nuk plotesojne kerkesat per:

- o Makineri printimi me cilesi me bojera UV ekologjike dhe boje te bardhe per printim ne materiale te buta dhe te forta (dru, forex, plexiglass) me ngjyra te ndryshme deri ne 3.5 m gjeresi.*
- o Makineri printimi me kapacitet te mjaftueshem prodhimi per materiale te buta (banners) me bojera UV ekologjike per ambiente te brendshme. Me kapacitet te mjaftueshem prodhimi dhe printimi i se ciles duhet te jete deri ne 5 m gjeresi.*
- o Makineri printimi per sinjalistika ne materiale per printim direkt ne materiale te forta. Mundesi printimi i sinjalistikave ne juhen e shenjave (reliev, boje te bardhe dhe transparente) ne menyre qe sinjalistika te jete e lexueshme edhe nga personat me shikim te kufizuar. Me kapacitet te mjaftueshem me sipërfaqe minimumi 120 cm x 60 cm.*
- o Makineri printimi per materialin tekstil me bojera uji ekologjike per ambiente te brendshme per personalizimin e perdeve dhe kalander per perpunim tekstili me gjeresi minimale 320 cm.*
- o Makineri prerese per materialet: Adeziv, Tekstil, pvc, dru, plexiglass, metal.*
- o Makineri lazer per funksionet: prerje metal, perpunim shkrime 3D*

Referuar dokumentacionit plotesues rezulton se nuk ka te dhena teknike te pasqyruara qe te deshmojne qe makinerite e deklaruar jane sipas kerkesave te mesiperme, pra jane dorezuar kontrata qiraje dhe fatuara tatimore blerje, zhdoganime, por qe nuk kane asnje te dhene qe te provoje se jane sipas kerkesave dhe qe mund te realizojne proceset e punes apo sherbimet e kerkuara ne objektin e kontrates. Skedat teknike te paraqitura nuk perputhen me te dhenat e deklaruar ne kontrata qiraje, apo fatura dhe deklarata zhdoganimi. Nuk jane pershkuar qarte modelet e makinerive ne fatura dhe deklarata zhdoganimi, ndersa ne skeda teknike te paraqitura si dokumentacion plotesues jane paraqitur te dhena per pjese te printerave si koka printer dhe jo per printera sic jane kerkuar. Nga ana tjeter edhe permasat e deklaruar ne skeda teknike per makinerit nuk permbushin kerkesat e vendosur ne dokumenta tenderi.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik Juaj nuk qëndron.

Ne perfundim te shqyrtimit te ankeses se paraqitur nga Ju, KSHA per te gjitha arsyet qe parashtruam me lart ka vendosur refuzimin e ankeses Tuaj.

II.9. Me qëllim shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues, Komisioni Prokurimit Publik me anë të shkresës nr. 3696/4 prot., datë 27.01.2024, me objekt “Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacionit dhe dokumentacionit KPP-së lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Filara” SHPK” i është drejtuar autoritetit kontraktor duke i kërkuar informacion si më poshtë vijon:

Aktualisht, nga ana e autoritetit kontraktor është dërguar vetëm informacion si dhe akti i trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues për procedurën e prokurimit objekt ankimi. Nga verifikimi në sistemin e prokurimeve elektronike konkretisht në rubrikën kërkesa rezulton se nga ana e autoritetit kontraktor më datë 14.11.2024 nëpërmjetë rubrikës kërkesa i është kërkuar operatorit ekonomik që të “dorëzohet dokumentacioni provues mbi vetëdeklarimin në shtojcën nr. 8, seksioni B (Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme) (nëse kërkohen) për disponimin e e mjeteve/makinerive me kontratë qiraje, ku përvec kontratës së qirasë kërkohet edhe dokumentacioni që vërteton pronsinë e qiradhënësit, por edhe sekde teknike, katalogun apo dokumentacion tjetër teknik që pasqyron të dhënat teknike”. Me qëllim vijimin e gjyimit të ankesës pranë KPP-së në përputhje me nenin 114 të LPP-së, autoriteti kontraktor të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, vetëm dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik “Filara” SHPK të paraqitur pranë autoritetit kontraktor në përgjigje të kërkesës së më sipër cituar.

Sa më sipër, me qëllim vijimin e gjyimit të ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik, i gjithë informacioni dhe dokumentacioni i sipërcituar të dorëzohet pranë KPP-së, brenda ditës së enjte datë 30.01.2025.

II.10. Me shkresën nr. 912/1 prot, datës 30.01.2025, me objekt “Dërgim dokumentacioni” protokolluar me tonën me nr. 3696/5 prot., datë 03.02.2024, autoriteti kontraktor ka dërguar pranë Komisionit Prokurimit Publik informacion dhe dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik “Filara” SHPK në përmbushje të kriterëve kualifikuese.

II.11. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020 për prokurimin publik.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Filara” SHPK, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi me arsyen se: “Nuk ka objekt veprimtari objektin e tenderit” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit”, gërma “a” e dokumentave të procedurës së prokurimit, është parashikuar si vijon:

Ofertuesi deklaron se:

a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

III.1.2. Në shtojcën 8/2 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.1/a të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

III.1.3. Në shtojcën 9 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pjesë e dokumenteve të tenderit, në Pjesën II, “Shkaqet e përjashtimit”, A: Deklaratë për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit”, ndër të tjera, parashikohet se:

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme_____

III.1.4. Në përmbushje të kriterit më sipër operatori ekonomik “Filara” SHPK ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik SPE dokumentacionin si më poshtë:

- Shtojca 9 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, ku në Pjesën II, “Shkaqet e përjashtimit”, A: Deklaratë për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit” është deklaruar si vijon:

“Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike si më poshtë vijon:

Adresën e ueb-it: ëëë.e-albania.al

Autoritetin ose organin lëshues: Qendra Kombëtare e Biznesit

Lloji i dokumentit: Ekstrakt i Thjeshtë.

III.1.5. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

Autoritetet ose entet kontraktorë përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

III.1.6. Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht : *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.”*

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.1.7. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: ***“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.***

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç)operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d)operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh)operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve¹ të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e)operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë)operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f)operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g)operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj)operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h)operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i)operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j)informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k)operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të V,

¹ Ndryshuar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021

si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rruqë elektronike². Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7.Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”

III.1.8. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim, ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

Në pikën 1 dhe 6 të nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla. 2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon: i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti; 6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

III.1.9. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar ka për detyrë d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

III.1.10. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Filara” SHPK, për sa i përket objektit të veprimtarisë së shoqërisë tij, gjykojmë se kriteri në lidhje me objektin e veprimtarisë së operatorit ekonomik ofertues, në përputhje me objektin e procedurës objekt ankimi, është një kërkesë e cila bën pjesë tek kriteret e përgjithshme të kualifikimit, ku referuar përcaktimeve në dokumentet e tenderit këto kriteret duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8. Sa më sipër, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “Rej” SHPK rezulton se në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, në Pjesën II, “Shkaqet e përjashtimit”, germa “A” “Deklarata për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit”, ky i fundit ka deklaruar: “Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike si më poshtë vijon:

Adresën e ueb-it: ëëë.e-albania.al

Autoritetin ose organin lëshues: Qendra Kombëtare e Biznesit

Lloji i dokumentit: Ekstrakt i Thjeshtë”.

Gjithashtu, nga verifikimi i Ekstraktit të Regjistrimit Tregtar për të dhënat e subjektit “Filara” SHPK, i publikuar në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare të Biznesit rezulton se objekti i aktivitetit të shoqërisë “Filara” SHPK është përcaktuar: *“Shtëpi Botuese, botime të ndryshme, artistike, letrare, shkollore, universitare dhe botimeve të monografive shkencore në fushën e albanologjisë. Shtypshkronje, shtypshkrime me element sigurie, fletpalosje, agjenda, flyer, katalog, kartvizita, banera, postera, roll up, kalendar muri, kalendar tavoline, canta, revista, letra me koke, blloqe recetash, stilolapsa me logo, broshura, zarfa, etiketa, etj. Agjenci trajnimesh për zhvillimin e vazhduar profesional, trajnimin dhe certifikimin e punonjesve arsimor, trajnime të ndryshme. Tregtim kancelarish të ndryshëm, mjete didaktike mesimore, produkte të ndryshme për arte dhe zeje. Organizim eventesh, dekore, festa dhe materiale promocionale të ndryshme. Printime dixhitale të të gjithave llojeve të reklamave dhe tabelave, logime, brandime, video promocionale, gjenerim platforme dixhitale, zhvillim dhe menaxhim aplikacioni ëëbi, etj..”*

Sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Filara” SHPK është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, pasi nga ana e tij është plotësuar Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, ku deklarohet se ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, si dhe në objektin e veprimtarisë së shoqërisë “Filara” SHPK, sipas Ekstraktit të Regjistrimit Tregtar si më sipër cituar rezulton se përfshihet objekti i prokurimit.

Për sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Filara” SHPK qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Filara” SHPK mbi kundërshtimin e e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi me pretendimin se: *“...Në datën 25.09.2024, enti juaj prokurues e ka modifikuar këtë kriter kualifikues, si më poshtë: Në shtojcën 8, pika 2.3.4 e Kapaciteteve Teknike, në dokumenta tenderit modifikohet : Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet/makinerite e mëposhtme: - Makineri printimi me cilësi me bojera UV ekologjike dhe boje të bardha për printim në materiale të buta dhe të forta (dru, forex, plexiglass) me ngjyra të ndryshme deri në 3.5m gjatësi. - Makineri printimi me kapacitet të mjaftueshëm prodhimi për materiale të buta (banners) me bojera UV ekologjike për ambiente të brendshme. Me kapacitet të mjaftueshëm prodhimi dhe printimi i se cilës duhet të jete deri në 5 m gjatësi. - Makineri printimi për sinjalistika në materiale për printim direkt në materiale të forta. Mundësi printimi i sinjalistikave në gjuhen e shenjave (reliev, boje të bardha dhe transparente) në mënyrë që sinjalistika të jete e lexueshme edhe nga personat me shikim të kufizuar. Me kapacitet të mjaftueshëm me sipërfaqe minimumi 120 cm x 60 cm. - Makineri printimi për materialin tekstil me bojera uji ekologjike për ambiente të brendshme për personalizimin e perdeve dhe kalander për përpunim tekstili me gjatësi*

minimale 320 cm. - Makineri prerese per materialet: Adeziv, Tekstil, pvc, dru, plexiglass, metal. - Makineri lazer per funksionet: prerje metal, perpunim shkrime 3D; - Te gjitha produktet e kerkuara jane per perdorim te ambienteve te brendeshme dhe nuk pranohet te jene me bashkime. - Nje makineri mund te kryej nje ose me shume funksione mjafton te vertetohet me te dhenat teknike (skede teknike apo cdo dokument tjeter te vlefshem qe verteton realizimin e proceseve te punes apo sherbimeve). - Printer mjaftojne edhe nga nje per secilin version. Mjafton te mbulojne permasen me te madhe te kerkuar pa bashkime. Ky modifikim behet ne zbatim te vendimit te KPP-se nr. 1227/2024 date 10.09.2024. Shënim: Ky kriter kualifikues eshte modifikuar duke HEQUR dokumentaconin me te cilin vërtetohet përmbushja e këtij kriteri dhe konkretisht është hequr pjesa si më poshte: Per te permbushur kriterin e mesiperm ne fazen e ofertimit, operatori ekonomik duhet te deklaroje disponimin e makinerive ne formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST. Sqarim: përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST, sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik i ndryshuar. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar, i pari duhet te dorëzoje dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat a, b, d, dh, e, h, i, j të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin). Megjithese për këtë kriter kualifikues nga ana e entit tuaj kontraktor nuk është kërkuar mënyra se si do te vërtetohet përmbushja e këtij kriteri, përsëri kompania Ffilara Sh.p.k ka dorëzuar në SPE shtojcën Nr. 9 Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit ku në pjesën III b: Deklaratë për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohej) ka deklaruar pajisjet që disponon dhe që janë kerkuar në këtë kriter kualifikues. (Bashkelidhur shtojca 9 Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit). Në datën 15.11.2024, në SPE mbërriti një kërkesë për sqarim nga autoriteti kontraktor, ku kërkonte si me poshte vijon: Mbeshtetur ne nenin 82 te VKM 285 dhe ne dokumentat e tenderit pika ne te cilen eshte kerkuar: - Për të vërtetuar disponimin e këtyre makinerive operatorët ekonomik duhet të paraqesin fatura tatimore ose zhdoganimin. Për makineritë me qira duhet të paraqitet kontrata e qirasë e vlefshme, e shoqëruar me dokumentacion që vërteton pronësinë e qiradhenësit (fatura tatimore ose zhdoganimi). Autoriteti kontraktor i lind e drejta të verifikojë disponimin e makinerive, per kete qellim operatorët ekonomike duhet të paraqesin nje deklarate te nenshkruar nga Administratori i shoqerise. - Lutemi te na vini ne dispozicion dokumentacionin provues mbi vetedeklarimin ne shtojcen nr. 8, seksioni B (për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme) (nëse kërkohej) per disponimin e mjeteve /makinerive me kontrate qiraje, ku pervec kontrates se qirase kerkohet edhe dokumentacioni qe verteton pronesine e qiradhenesit, por edhe skede, teknik,, katalogun apo dokumentacion tjeter teknik qe pasqyron te dhenat e makinerive. Dokumentacioni i kerkuar duhet te dorezohet brenda 3 diteve. Kjo kerkese e KVO-se ishte ne kundërshtim me parashikimet e nenit 82 te VKM 285 Per miratimin e rregullave te prokurimit publik, i ndryshuar, pasi në këtë faze të vleresimit KVO-ja nuk mund te aplikonte përcaktimet e këtij neni, pasi sikurse permendem dhe me lart ky kriter kualifikues nuk linte vend per sqarime. Kjo kërkesë e KVO-së për të dorëzuar kontraten e qerases apo te deklarates së zhdoganimit apo të fatures tatimore të blerjes për të vërtetuar disponimin e makinerive të

percaktuara në piken 2.3.4 të shtojcës 8 të DST-së është në kundërshtim me vete këtë kriter kualifikues, pasi sikurse përmendem dhe me lart ky kriter kur është modifikuar nuk është përcaktuar nga enti juaj prokurues se me çfarë dokumentacioni do të vërtetohet. Kjo kërkesë e KVO-se për të dorëzuar skedat teknike të makinerive të përcaktuara në piken 2.3.4 të shtojcës 8 të DST-ve është në tejkalim të vetë përcaktimeve të kriterit kualifikues të përcaktuar në piken 2.3.4 të shtojcës 8 të DST-ve, pasi sikurse përmendem dhe me lart në këtë kriter kualifikues të modifikuar nga ana e entit tuaj kontraktor nuk është kërkuar që të dorëzohen skedat teknike të makinerive të kërkuara. Ndonëse kërkesa e KVO-së e datës 15.11.2024 është bërë në shkelje të procedurave të parashikuara nga rregullat e prokurimit publik (të sipërpermendura), përsëri kompania jon “Filara” nuk hezitoi që ti dërgonte dokumentacionin vërtetues, duke dorëzuar në datën 19.11.2024 skedat teknike për të vërtetuar disponimin e makinerive të kërkuara në kriterin kualifikues të pikës 2.3.4 të shtojcës 8 të DST-ve”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.2. Në shtojcën 8/2 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.1/a të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

III.2.3. Në shtojcën 9 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pjesë e dokumenteve të tenderit, në Pjesën III, “Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit”, B: “Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)”, ndër të tjera, parashikohet se:

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:	<u>Punonjës</u>
Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më	Po [] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve: Profili i punonjësve <u>Makineri e mjete</u>

kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	Po [] Jo [] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete: _____
Emri, Mbiemri _____ Firma _____ Vula _____ Data e dorëzimit të deklaratës _____	

III.2.4. Në shtojcën 8/2 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.4 “Kapaciteti teknik” e modifikuar të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi është përcaktuar kriteri si më poshtë:

Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet/makinerite e mëposhtme:

- *Makineri printimi me cilesi me bojera UV ekologjike dhe boje te bardhe per printim ne materiale te buta dhe te forta (dru, forex, plexiglass) me ngjyra te ndryshme deri ne 3.5m gjeresi.*
- *Makineri printimi me kapacitet te mjaftueshem prodhimi per materiale te buta (banners) me bojera UV ekologjike per ambiente te brendshme. Me kapacitet te mjaftueshem prodhimi dhe printimi i se ciles duhet te jete deri ne 5 m gjeresi.*
- *Makineri printimi per sinjalistika ne materiale per printim direkt ne materiale te forta. Mundesi printimi i sinjalistikave ne gjuhen e shenjave (reliev, boje te bardhe dhe transparente) ne menyre qe sinjalistika te jete e lexueshme edhe nga personat me shikim te kufizuar. Me kapacitet te mjaftueshem me siperfaqe minimumi 120 cm x 60 cm.*
- *Makineri printimi per materialin textil me bojera uji ekologjike per ambiente te brendshme per personalizimin e perdeve dhe kalander per perpunim tekstili me gjeresi minimale 320 cm.*
- *Makineri prerese per materialet: Adeziv, Tekstil, pvc, dru, plexiglass, metal.*
- *Makineri lazer per funksionet: prerje metal, perpunim shkrime 3D*
- *Te gjitha produktet e kerkuara jane per perdorim te ambienteve te brendeshme dhe nuk pranohet te jene me bashkime.*
- *Nje makineri mund te kryej nje ose me shume funksione mjafton te vertetohet me te dhenat teknike (skede teknike apo cdo dokument tjeter te vlefshem qe verteton realizimin e proceseve te punes apo sherbimeve).*

- Printer mjaftojne edhe nga nje per secilin version. Mjafton te mbulojne permasen me te madhe te kerkuar pa bashkime.

Ky modifikim behet ne zbatim te vendimit te KPP-se nr. 1227/2024 date 10.09.2024.

III.2.5. Për përmbushjen e kriterit kualifikuese të përcaktuar në pikën 2.3.4 “Kriteret E Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit” të Shtojcën 7 “Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit”, operatori ekonomik ofertues “Filara” SHPK ka dorëzuar në dokumentacionin e ofertës, si më poshtë vijon:

- Shtojcën 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, i vulosur dhe i firmosur nga administratori i shoqërisë, ku në Seksionin B “Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit” ka deklaruar si më poshtë vijon:

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:	<u>Punonjës</u> Po [X] Jo []
Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	Nëse, po, numri i punonjësve: 13 Punonjës
	Profili i punonjësve Z. G. M, me profesion Disenjator grafikësh i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin Disenjator grafikësh;
	<u>Makineri e mjete</u> Po [X] Jo []
	Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete: 1. Makineri per printime ne sticker te cilesise se larte me bojera ekologjike dhe boje te bardhe per materiale transparente, e pervetsuar nepermjet kontrates se qirase ndermjet paleve Nr. 41 Prot., Dt. 12.07.2024 me afa te te packatuar; 2. Makineri printimi e cilesise se larte me bojera UV ekologjike dhe boje te bardhe per printim ne materiale te buta dhe te forta me ngjyra te ndryshme minimumi 5m gjeresi, e pervetsuar

	nepermjet kontrates se qirase ndermjet paleve Nr.56 Prot., Dt. 29.10.2024 me afat te packatuar; 3. Makineri printimi me kapacitet te mjaftueshem prodhimi per materiale te buta (banners) me bojera UV ekologjike per ambiente te brendshme, e pervetsuar nepermjet kontrates se qirase ndermjet paleve Nr. 56 Prot., Dt. 29.10.2024 me afat te packatuar; 4. Makineri printimi per sinjalistika ne materiale per printim direkt ne materiale te forta, e pervetsuar nepermjet kontrates se qirase ndermjet paleve Nr.56 Prot., Dt. 29.10.2024 me afat te packatuar; 5. Makineri printimi per materialin textil me bojera uji ekologjike per ambiente te brendshme, e pervetsuar nepermjet kontrates se qirase ndermjet paleve Nr.57 Prot., Dt. 29.10.2024 me afat te packatuar; 6. Makineri prerese per materialet: Adeziv, Tekstil, pvc, dru, plexiglass, metal etj., e pervetsuar nepermjet kontrates se qirase ndermjet paleve Nr. 41 Prot., Dt. 12.07.2024 me afat te packatuar; 7. Makineri lazer per funksionet: prerje metal, perpunim shkrime 3D, ne pronesi vertetuar nepermejet kontrates se qirase Nr. Fat. 80 Dt 10.09.2015; 8. Automjet ne pronesi, me targje AA647AX, me leje qarkullimi Nr. LAD0385620 dhe Nr. Shasie EV2ZZZ2KZ5X084652;
Emri, Mbiemri _____ Firma _____ Vula _____ Data e dorëzimit të deklaratës _____	

- Deklatë për Kontrollin e Mjeteve “Unë i nënshkruari F. Xh, nën cilësin e administratorit të operatorit ekonomik “Filara” SHPK deklarojë nën përgjegjësin time të plotë se: Operatori ekonomik Filara shpk pjesëmarrës në oricedurën e prokurimit

nga autoriteti kontraktor Operatori i Shperndarjes se Energjisë Elektrike Group sh.a për objektin “Furnizim, vendosje dhe mirëmbajtje e elementëve të brandimit në qëndrat e Kujdesit ndaj Klientit dhe zyrat Administrative të OSHEE Group sha, për dy vjet” dhe Nr. Ref-12184-07-04-2024, zotëron të gjitha makinerit e kërkuara nga autoriteti kontraktor për realizimin e procedurës objekt prokurimi dhe autoritetit kontraktor i lind e drejta të verifikojë në cdo kohë disponimin e makinerive, të cilat ndodhen në Selinë Qëndrore të Shoqërisë.

III.2.6. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor dërguar më shkresën nr. 912/1 prot, datë 30.01.2025, protokolluar me tonën me nr. 3696/5 prot, datë 03.02.2025, konstatohet se operatori ekonomik “Filara” SHPK i kualifikuar i pari, pas kërkesës së autoritetit kontraktor më datë 14.11.2024 nga rubrika kërkesa nëpërmjetë sistemit të prokurimeve elektronike, ka dorëzuar pranë autoritetit kontraktor dokumentacionin fizik sipas parashikimeve të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, për përmbushjen e kriterëve kualifikuese të përcaktuara në pikën 2.3.4 “Kriteret e Përgjithshme Të Përzgjedhjes/ Kualifikimit” të Shtojcën 7 “Formulari i Kriterëve të Përzgjedhjes/Kualifikimit” ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë vijon:

- 1- Kontratë Qeraje nr. 57 prot, datë 29.10.2024 midis qeradhënësit znj B. D dhe qeramarrësit shoqërisë Filara shpk me objekt makineritë e përcaktuara në këtë kontratë, si dhe faturën e blerjes nr. 700, datë 07.08.2023.
- 2- Kontratë Qeraje nr. 56 prot, datë 29.10.2024 midis qeradhënësit Index Group dhe qeramarrësit shoqërisë Filara shpk me objekt makineritë e përcaktuara në këtë kontratë, si dhe aktin e zhdoganimit R. 34719, datë 12.04.2023, R. 23223, datë 13.03.2023, R. 34718, datë 12.04.2023, R. 34719, datë 12.04.2023, Faturë Blerje nr. IHR2023000000003, datë 08.04.2023.
- 3- Kontratë Qeraje nr. 41 prot, datë 12.07.2024 midis qeradhënësit znj E. M dhe qeramarrësit shoqërisë Filara shpk me objekt makineritë e përcaktuara në këtë kontratë, si dhe faturën e blerjes nr. 325, datë 27.06.2019, faturën e blerjes nr. 636, datë 27.12.2018, faturën e blerjes nr. 22, datë 31.12.2018, faturën e blerjes nr. 21, datë 31.12.2018, faturën e blerjes nr. 71, datë 20.05.2019.
- 4- Faturë e Thjeshtë Tatimore nr. 80, datë 10.09.20215.
- 5- Katalog për makineritë.

III.2.7. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;

d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik

dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

III.2.8. Në nenin 77, pika 1 dhe pika 4, “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikon shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të

zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

III.2.9. Neni 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”, pika 2 dhe pika 4 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikon shprehimisht se:

“2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshme për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.”.

III.2.10. Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se: *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji.** Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm. 2. **Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të qarrantuar zbatimin korrekt të procedurës.***

III.2.11. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, *autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.*

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rruqë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

III.2.12. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.2.13. Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, për skualifikimin e tij në mënyrë të pa drejtë nga ana e autoritetit kontraktor, Komisioni nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik nga operatori ekonomik “Filara” SHPK, konstaton, se ky i fundit ka paraqitur Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, nga verifikimi i të cilit konstatohet, se është plotësuar sipas Shtojcës 9 të dokumenteve të tenderit. Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, dokumentet e tenderit, si dhe informacioni dhe dokumentacioni i dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, ky i fundit konstaton, se operatori ekonomik “Filara” SHPK, si operator ekonomik i kualifikuar i pari në këtë procedurë prokurimi, në zbatim të nenit 26 pika 6 të Vendimit të Këshillit të

Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe kërkesës së autoritetit kontraktor të datës 14.11.2024 nëpërmjetë rubrikës kërkesa nga sistemi i prokurimeve elektronike, ka paraqitur pranë autoritetit kontraktor dokumentet provuese të parashikuara në shkronjën “i”, të pikës 2 të këtij neni. Nga shqyrtimi i këtij dokumentacioni, konstatohet, se operatori ekonomik “Filara” SHPK, në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, në Pjesën III, B: Deklaratë Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme, në lidhje me makineritë ka deklaruar, se disponon mjetet dhe pajisjet e kërkuara nga autoriteti kontraktor, duke i listuar ato, **1- Makineri per printime ne sticker te cilesise se larte me bojera ekologjike dhe boje te bardhe per materiale transparente, e pervetsuar nepermjet kontrates se qirase ndermjet paleve Nr. 41 Prot., Dt. 12.07.2024 me afate te packatuar; 2- Makineri printimi e cilesise se larte me bojera UV ekologjike dhe boje te bardhe per printim ne materiale te buta dhe te forta me ngjyra te ndryshme minimumi 5m gjeresi, e pervetsuar nepermjet kontrates se qirase ndermjet paleve Nr.56 Prot., Dt. 29.10.2024 me afate te packatuar; 3- Makineri printimi me kapacitet te mjaftueshem prodhimi per materiale te buta (banners) me bojera UV ekologjike per ambiente te brendshme, e pervetsuar nepermjet kontrates se qirase ndermjet paleve Nr. 56 Prot., Dt. 29.10.2024 me afate te packatuar; 4- Makineri printimi per sinjalistika ne materiale per printim direkt ne materiale te forta, e pervetsuar nepermjet kontrates se qirase ndermjet paleve Nr.56 Prot., Dt. 29.10.2024 me afate te packatuar; 5- Makineri printimi per materialin textil me bojera uji ekologjike per ambiente te brendshme, e pervetsuar nepermjet kontrates se qirase ndermjet paleve Nr.57 Prot., Dt. 29.10.2024 me afate te packatuar; 6- Makineri prerese per materialet: Adeziv, Tekstil, pvc, dru, plexiglass, metal etj., e pervetsuar nepermjet kontrates se qirase ndermjet paleve Nr. 41 Prot., Dt. 12.07.2024 me afate te packatuar; 7- Makineri lazer per funksionet: prerje metal, perpunim shkrime 3D, ne pronesi vertetuar nepermejet kontrates se qirase Nr. Fat. 80 Dt 10.09.2015; Gjithashtu në përmbushje të kriterit 2.3.4 në lidhje disponimin e makinerive pas kërkesës së autoritetit kontraktor ka dorëzuar pranë këtij të fundit dokumentacionin provues **1- Kontratë Qeraje nr. 57 prot, datë 29.10.2024 midis qeradhënësit znj B. D dhe qeramarrësit shoqërisë Filara shpk me objekt makineritë e përcaktuara në këtë kontratë, si dhe faturën e blerjes nr. 700, datë 07.08.2023; 2- Kontratë Qeraje nr. 56 prot, datë 29.10.2024 midis qeradhënësit Index Group dhe qeramarrësit shoqërisë Filara shpk me objekt makineritë e përcaktuara në këtë kontratë, si dhe aktin e zhdoganimit R. 34719, datë 12.04.2023, R. 23223, datë 13.03.2023, R. 34718, datë 12.04.2023, R. 34719, datë 12.04.2023, Faturë Blerje nr. IHR2023000000003, datë 08.04.2023. 3- Kontratë Qeraje nr. 41 prot, datë 12.07.2024 midis qeradhënësit znj E. M dhe qeramarrësit shoqërisë Filara shpk me objekt makineritë e përcaktuara në këtë kontratë, si dhe faturën e blerjes nr. 325, datë 27.06.2019, faturën e blerjes nr. 636, datë 27.12.2018, faturën e blerjes nr. 22, datë 31.12.2018, faturën e blerjes nr. 21, datë 31.12.2018, faturën e blerjes nr. 71, datë 20.05.2019. 4- Faturë e Thjeshtë Tatimore nr. 80, datë 10.09.20215. 5- Katalog për makineritë.** Nga shqyrtimi i kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.4 “Kapaciteti teknik” të shtojcës 8 “Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit” të dokumentave të tenderit të modifikuara të procedurës së prokurimit objekt ankimi, Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor ka kërkuar që opertorët ekonomikë ofertues që të kualifikohen për këtë kriter kualifikues, duhet të të paraqesin fatura tatimore ose zhdoganimin ose për makineritë me qira duhet të paraqitet kontrata e qirasë e vlefshme, e shoqëruar me dokumentacion që vërteton pronësinë e qiradhënësit (fatura tatimore ose zhdoganimi) për**

pajisjet si në vijim: “• Makineri printimi me cilesi me bojera UV ekologjike dhe boje te bardhe per printim ne materiale te buta dhe te forta (dru, forex, plexiglass) me ngjyra te ndryshme deri ne 3.5m gjeresi; • Makineri printimi me kapacitet te mjaftueshem prodhimi per materiale te buta (banners) me bojera UV ekologjike per ambiente te brendshme. Me kapacitet te mjaftueshem prodhimi dhe printimi i se ciles duhet te jete deri ne 5 m gjeresi; • Makineri printimi per sinjalistika ne materiale per printim direkt ne materiale te forta. Mundesi printimi i sinjalistikave ne gjuhen e shenjave (reliev, boje te bardhe dhe transparente) ne menyre qe sinjalistika te jete e lexueshme edhe nga personat me shikim te kufizuar. Me kapacitet te mjaftueshem me siperfaqe minimumi 120 cm x 60 cm; • Makineri printimi per materialin tekstil me bojera uji ekologjike per ambiente te brendshme per personalizimin e perdeve dhe kalander per perpunim tekstili me gjeresi minimale 320 cm; • Makineri prerese per materialet: Adeziv, Tekstil, pvc, dru, plexiglass, metal; • Makineri lazer per funksionet: prerje metal, perpunim shkrime 3D; • Te gjitha produktet e kerkuara jane per perdorim te ambienteve te brendeshme dhe nuk pranohet te jene me bashkime; Nje makineri mund te kryej nje ose me shume funksione mjafton te vertetohet me te dhenat teknike (skede teknike apo cdo dokument tjeter te vlefshem qe verteton realizimin e proceseve te punes apo sherbimeve); Printer mjaftojne edhe nga nje per secilin version. Mjafton te mbulojne permasen me te madhe te kerkuar pa bashkime”, vërtetuar kjo me nëpërmjet paraqitjes së dokumentacionit si në vijim: “fatura tatimore ose zhdoganimin. Për makineritë me qira duhet të paraqitet kontrata e qirasë e vlefshme, e shoqëruar me dokumentacion që vërteton pronësinë e qiradhënësit (fatura tatimore ose zhdoganimi)”. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik dhe dokumentacionit fizik të dorëzuar nga operatori ekonomik “Filara” ShPK, konstatohet, se ky i fundit ka paraqitur dokumentacionin për disponimin e mjeteve të përcaktuara në kriterin kualifikues të sipërpërmendur, ku vërtetohet se disponon nëpërmjetë kontratave të qerasë makineritë e sipërcituara. Komisioni rithekson, se vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi duhet të paraqesin dokumentacionin e kërkuar në përputhje me kriterin e veçantë të kualifikimit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit sa i takon mjeteve të kërkuar, duke garantuar autoritetin kontraktor për përmbushjen me sukses të kontratës objekt-prokurimi. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor duhet të vlerësojë ofertuesit pjesëmarrës vetëm për atë që ka kërkuar në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi. Kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës dhe rrjedhimisht ky i fundit do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Një ndër qëllimet kryesore të ligjit për prokurimin

publik është ai i sigurimit të një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik. Në këtë kuptim KPP gjykon, se operatori ekonomik “Filara” SHPK plotëson kriterin e veçantë të kualifikimit të përcaktuar në pikën 2.3.4 të Shtojcës 8 të dokumenteve të tenderit të modifikuara të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

Gjithashtu, Vlen të theksojmë, se në çdo rast është përgjegjësi e autoritetit kontraktor, që në momentin e marrjes në dorëzim të mallit/shërbimit objekt - prokurimi, të kërkojë nga operatori ekonomik që të vërtetojë përmbushjen e kërkesave dhe specifikimeve teknik. Akoma më tej, vlen të theksojmë, se autoriteti kontraktor disponon të gjitha elementet e nevojshme procedurale si garanci, në rast të shkeljes së kontratës, konkretisht neni 83 “*Sigurimi i ofertës*” i Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenet 36 “*Sigurimi i kontratës*”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se në bazë të nenit 124 “*Detyrimet e autoritetit ose entit kontraktor gjatë zbatimit të kontratës*” të LPP, si dhe nenit 107 “*Zbatimi dhe mbikëqyrja e kontratës*” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti kontraktor ka një rol të posaçëm, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t’u siguruar nëse cilësia e mallit do të jetë e njëjtë me cilësinë dhe specifikimet teknike të premtuara në ofertë dhe të përcaktuara në kontratë. Në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara, autoriteti kontraktor zbaton penalitetet e parashikuara në kontratë, apo detyrimet, në mbështetje të ligjit dhe rregullave për prokurimin publik, si më sipër cituar.

Për sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Filara” SHPK qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Filara” SHPK, për kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e operatorit ekonomik “Dixhi Print Al” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, referuar vlerësimit të kryer nga autoritetit kontraktor, rezulton se operatori ekonomik ankimues “Filara” SHPK ka ofertuar me vlerë më të ulët kundrejt operatorit ekonomik “Dixhi Print Al” SHPK për të cilin paraqet pretendime për kualifikim, duke mos pasur kështu një interes të ligjshëm të ankohet për operatorë ekonomikë të renditur sipër tij, referuar vlerës ekonomike. Sa më sipër, KPP gjykon, se është e nevojshme të ndalet në elementet e testit të legjitimitetit në një procedurë ankimi përpara KPP. Këto elementë janë interesi i ankuesit, dëmi real ose potencial i pritshëm dhe ekzistenca e një vendimi të një autoriteti kontraktor i marrë në kundërshtim me ligjin. Një ankimues do të konsiderohet i dëmtuar apo disavantazhuar, kur ai ka vuajtur apo rrezikon dukshëm të vuajë personalisht një pasojë të ardhur drejtpërdrejtë nga veprimi i autoritetit kontraktor dhe kjo mund të kurohet (rregullohet) përmes ankimit në KPP. Gjithashtu, akti i pretenduar duhet të ketë ndodhur në hapësirën e të drejtave të tij ligjore në kuadrin e një procedure prokurimi publik. I vetmi interes i ligjshëm, që mund të ketë një operator ekonomik i dëmtuar nga një vendim i një autoriteti kontraktor, i dhënë në kuadrin e një procedure

prokurimi është që përmes ankimit në KPP, ai të fitojë kontratën. Në rastin konkret, KPP konstaton, se operatori ekonomik “Filara” SHPK, rezulton i klasifikuar me ofertë më të ulët ekonomike se operatori ekonomik “Dixhi Print Al” SHPK, rrjedhimisht duke mos patur interes mbi kualifikimin e këtij të fundit. Akoma më tej, referuar arsyetimit të këtij vendimi operatori ekonomik “Filara” SHPK, do të kualifikohet në këtë procedurë prokurimi, duke realizuar kështu interesin e tij të ligjshëm dhe nuk ka sesi të dëmtohet nga suksesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi të cilët kanë ofertuar me një vlerë më të lartë ekonomike

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik “Filara” SHPK, për skualifikimin e operatorit ekonomik “Dixhi Print Al” SHPK, nuk do të merren në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Filara” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur shërbime mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-12184-07-04-2024, me objekt “Furnizim, vendosje dhe mirëmbajtje e elementeve të brandimit në Qëndrat e Kujdesit ndaj Klientit dhe zyrat Administrative të OSHEE Group sh.a per dy vjet” me fond limit: 39,848,500 (tridhjetë e nëntë milion e tetëqind e dyzet e tetë mijë e pesëqind) leke, pa TVSH ose 396,147.7 (treqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e dyzet e shtatë pikë shtatë) euro pa TVSH. Referuar kursit të këmbimit të B.SH datë 04.07.2024 1 euro = 100.59 All, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 30.10.2024 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike Group sh.a.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së, për skualifikimin e operatorit ekonomik “Filara” SHPK dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e kualifikuar këtë operator ekonomik.
3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.

4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “*Filara*” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK			
Nënkryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Fiorent Zguro	Kreshnik Ternova	Anila Malaj	Gjergj Mersini
Kryetar			
Jonaid Myzyri			